



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:**

Agjencioni për Elektro Komunikime

**Lënda e revizionit:**

Revizion i pasqyrave financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

**Qëllimi i revizionit:**

A janë pasqyrat financiare të liruara nga gabime në të gjitha aspektet materiale, si dhe a janë aktivitetet dhe transaksionet financiare të reflektuara në to, në përputhje me dispozitat ligjore.

**Gjendjet kyçe të identifikuara:**

- Nevoja për harmonizimin e aktit për sistematizimin e vendeve të punës me legjislacionin dhe aktet nënligjore;
- Procedura për inventarizimin e pasurive, të arkëtueshmeve dhe detyrimeve nuk është kryer plotësisht në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme të Agjencisë.

**Opinionit i dhënë \*:**



Kemi shprehur opinion me rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare, ndërsa për pajtueshmërinë me legjislacionin, udhëzimet dhe politikat e vendosura, kemi shprehur opinion pa rezervë.

**Rekomandimet kyçe:**

- Harmonizimi i aktit për sistematizimin e vendeve të punës me dispozitat e legjislacionit dhe akteve nënligjore;
- Ekzekutim i plotë i procedurave për inventarizim.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

- Rregullimi i mënyrës së shpërndarjes së pjesës së të ardhurave të destinuara për financimin e Agjencisë Operative-Teknike;
- Harmonizimi i lartësisë së shumës së gjobave në legjislacion

**Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:**

Janë marrë vërejtje mbi draft Raportin e Revizorit të Autorizuar Shtetëror, ku shtatë nga tetë vërejtje janë me karakter shpjegues, ndërsa një vërejtje pranohet.

**Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:**

Përgjigja ndaj vërejtjeve është shtojcë e Raportit Përfundimtar.

\*  pozitive,  me rezervë,  i pafavorshëm,  i përmbajtur